

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit N.P.N V.P.me seli në Gj.,ndaj të të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë,në praninë e të të autorizuarëve të palëve ndërgjyqëse (të të autorizuarit me shkrim avokatit S.M. nga V. i cili e përfaqësoj palën paditëse dhe të të autorizuarës me shkrim nga avokatura shtetërore I.A. e cila e përfaqësoj palën e paditur),lidhur me pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej;14.444,50 Euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;12.01.2016,ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare të hartuar me shkrim nga palët ndërgjyqëse,me datën;25.01.2016 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.P.N V.P.me seli në Gj..

I.Detyrohet pala e paditur që ti paguaj palës paditëse,shumën e përgjithshme prej;4.607,32 euro (katërmijë e gjashtëqind e shtatë euro e tridhjetë e dy cent),në emër të punimeve të kryera në ndërtesën e Stacionit Policor në I.,të gjitha këto me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuar në bankat e Kosovës,duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive të borxhit,në afatin partitiv prej 7 (shtatë) ditëve,nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim pas pranimit të këtij aktgjykimi.

II.Shpenzimet e procedurës kontestimore,pala e paditur detyrohet ti paguaj palës paditëse në shumën e përgjithshme prej;971,00 euro,në afatin kohor prej 7 (ditëve) pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim

A r s y e t i m

Paditësi N.P.N V.P.me seli në Gj. me datën;15.03.2013 ka parashtruar pranë kësaj gjykate padinë e saj lidhur me pagesën e borxhit në emër të kryerjes së punimeve rreth vendosjes së kulmit në Stacionin Policor në I. në shumën e përgjithshme prej;14.444,50 euro,me kamatë ligjore prej 4.2 % prej momentit të ushtrimit të kësaj padie e deri në pagesën definitive të borxhit të gjitha këto në afat kohor prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim,ndaj palës së paditur Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë,duke kërkuar në të njëjtën kohë nga kjo gjykatë aprovimin e saj si të bazuar,pas administrimit të të gjitha provave relevante të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Shqyrtimi paraprak i padisë.

Gjykata me rastin e pranimit të kësaj padie dhe në vazhdimësi ka analizuar, vërtetuar dhe ka konstatuar se ka kompetencë lëndore lidhur me shqyrtimin e çështjes juridike të parashtruar si në petitumin e padisë duke iu referuar dispozitave të nenit 29 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës si dhe nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat të Kosovës.

Gjykata paraprakishtë ka njohtuar me aktvendim për përgjigje në padi palën e paditur, e cila në afatin ligjor prej 7 (shtatë) ditëve konkretisht me datën; 28.03.2013 me rastin e dhënjes së përgjigjes në padi ka kundërshtuar kërkesëpadinë e palës paditëse, duke u thirrur në mungesë të provave të ofruara nga pala paditëse, andaj edhe i ka propozuar gjykatës të detyroj palën paditëse konform nenit 99 paragrafi 3 dhe nenit 100 të LPK-së, të ofroj provat, pasi që barra e të provuarit bie në palën paditëse, në mënyrë që pala e paditur të deklarohet lidhur me pretendimet e palës paditëse në këtë çështje juridike.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i palës paditëse në seancën përgatitore, në seancat e mbajtura kryesore dhe në fjalën e tij përfundimtare ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë së palës paditëse që konsiston në pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme prej; 4.607,32 euro, lidhur me kryerjen e punimeve për rinovimin e ndërtesës së Stacionit Policor në I., dhe atë pas marrjes së mendimit dhe konstatimit të ekspertit të ndërtimtarisë ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumën e lartëcekur, e tëra kjo duke u bazuar në kontratën e nënshkruar nga palët ndërgjyqëse të datës; 02.11.2012. Ndërsa sa i përket pretendimeve të palës së paditur për mosrespektim të kontratës pala paditëse është thirrur në fuqinë madhore, duke sqaruar se punimet kanë filluar në vjeshtë me fillimin e të reshurave atmosferike, ku edhe i është tërhjekur vërejtja të të paditurës për pasojat nëse vazhdohet me punimet, ndërsa në marrëveshje më të paditurën kanë filluar punimet edhe përkundër faktit se me rastin e shtrirjes së Hiberçikut/ESTRUT, janë kryer edhe punë shtesë, mirëpo pala paditëse kërkon vetëm atë që ka konstatuar eksperti i ndërtimtarisë në mendimin dhe konstatimin e tij të dhënë në ekspertizën e tij të hartuar me shkrim.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në fjalën e tij përfundimtare të hartuar me shkrim.

E autorizuar e palës së paditur si në përgjigjen në padi, seancën përgatitore, në seancat e mbajtura kryesore e poashtu edhe në fjalën e saj përfundimtare të hartuar me shkrim të datës; 25.01.2016, ka mbetur pranë pohimit të saj se ndaj palës paditëse nuk ka kurrëfarë detyrimi, për faktin se kontrata nuk është përmbushur nga pala paditëse dhe e tërë kjo vërtetohet përmes Email-ve të shkëmbyer në me të palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike, ku disa herë i është tërhjekur vërejtja palës paditëse për mosrespektimin e kontratës, andaj edhe bazuar në të cekurat më lartë i ka propozuar gjykatës refuzimin e kërkesëpadisë së paditëse në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka cekur.

Me rastin e administrimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka bërë leximin e tyre duke filluar nga kontrata e nënshkruar nga të dy palët ndërgjyqëse e datës;02.11.2012,raporti i punëve të kryera nga pala paditëse,përgjigja në padi,parashtresa e paditësit e datës;30.12.2013,njohtimi për dhënjen e kontratës e datës;25.09.2013,ekspertiza e hartuar nga eksperti i ndërtimtarisë e datës;24.03.2014,parashtresa lidhur me precizimin e kërkesëpadisë e datës;14.12.2015,komunikimet e palëve ndërgjyqëse përmes Email-ve të datës;23.12.2012,19.12.2012,25.03.2012,si dhe Email-at e datës;19.12.2012 dhe 25.03.2013 në mes të personave tjerë.

Gjykata me rastin e miratimit të kërkesëpadisë së palës paditëse është bazuar paraprakishtë në kontratën e nënshkruar nga palët ndërgjyqëse të datës;02.11.2012,pastaj në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të ndërtimtarisë së datës;24.03.2014,andaj edhe bazuar në këto prova relevante duke iu referuar dispozitës së nenit 630 të LMD-së,si dhe nenit 262 të LMD-së ka detyruar palën e paditur për pagesën e detyrimit të tij ashtu si është cekur në pikën një të dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me shqyrtimin,konstatimin dhe çmuarjen e të gjitha provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse është bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPK-së,lidhur me afatin paritiv është bazuar në dispozitën e nenit 509 pika e të LPK-së,ndërsa lidhur me llogaritjen e kamatës ligjore është bazuar në dispozitën e nenit 277 të LMD-së.

Duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së,duke i aprovuar propozimin e palës së paditëse për pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore nga e pala e paditur në shumën e përgjithshme prej;971,00 euro,dhe atë si në vijim;për pagesën e taksës gjyqësore shumën prej;51,00 euro,shumën prej;300,00 euro në emër të pagesës së ekspertit të ndërtimtarisë,shumën prej;80,00 euro në emër të precizimit të kërkesëpadisë,si dhe shumën prej 540,00 euro në emër të përfaqësimit për katër seanca të mbajtura (4 x 135,00 euro).

Gjykata pas shtjellimit të kësaj çështje juridike ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitat e nenit 262,nenit 277, nenit 630 të LMD-së,si dhe në dispozitat e nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
C.nr.115/2013 me datën;25.01.2016

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE:Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.